



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr.493, datë 21.10.2020

PËR
CAKTIMIN E STRUKTURËS SË POSAÇME PËR REGJISTRIMIN, ADMINISTRIMIN
DHE PËRPUNIMIN E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT, NË ZBATIM TË
LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË
ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”, I
NDRYSHUAR, NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, (i ndryshuar), si dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit,

V E N D O S I:

1. Caktimin e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, si strukturë e posaçme, për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit, në zbatim të nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, dhe vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015.
2. Formularët e vetëdeklarimit dhe i gjithë dokumentacioni i krijuar nga struktura e posaçme e caktuar me vendimet nr.39, datë 11.4.2016 dhe nr. 54, datë 25.4.2016, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i dorëzohen me procesverbal, strukturës së posaçme të caktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Shfuqizimin e vendimit nr.39, datë 11.4.2016 dhe vendimit nr.54, datë 25.4.2016, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për caktimin e personave përgjegjës nga Departamenti të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR